



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:209522

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734710

KE.nr.738/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të propozuesit “Teuta.Cos” SH.P.K., me seli në Prizren, rruga ”Ferizaji”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naser Peci, avokat nga Prishtina, ndaj kundërpropozuesit “Rient” SH.P.K., me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valon Jupa, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me kërkesën për shpallje të ekzekutueshëm të vendimit të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 23.05.2024, në prezencë të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T V E N D I M

Shpallet i ekzekutueshëm vendimi i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit - Oda Ekonomike e Kosovës, Nr.ARB-21/208 të datës 19.12.2019, në çështjen ndërmjet paditësit “Teuta.Cos” SH.P.K., ndaj të paditurit “Rient” SH.P.K.

A r s y e t i m

Propozuesi përmes të autorizuarit të tij, me datë 03.10.2023, pranë kësaj gjykata ka paraqitur kërkesë për shpallje të ekzekutueshëm të vendimit Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Kosovës me Nr. Nr. ARB-21/208 të datës 19.12.2019.

Kundërpropozuesi përmes të autorizuarit të tij me datë 15.05.2024 ka paraqitur kundërshtim ndaj kërkesës për shpallje të ekzekutueshëm të vendimit Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Kosovës me Nr. Nr. ARB-21/208 të datës 19.12.2019,

me të cilin ka kundërshtuar në tërësi kërkesën e paraqitur duke pretenduar se ekzistojnë arsye për anulimin e vendimit i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit, të përcaktuara në nenin 36 të Ligjit për Arbitrazhin.

Gjykata me datë 23.05.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë qenë të pranishëm përfaqësuesi i propozuesit dhe përfaqësuesi i kundërpropozuesit.

Përfaqësuesi i propozuesit gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se qëndron pranë kërkesës që vendimi i arbitrazhit të shpallet i ekzekutueshëm duke theksuar se gjykatës i janë ofruar të gjitha provat nga të cilat mund të vërtetohet se nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet që përcakton neni 36 i Ligjit për Arbitrazhin për anulimin e vendimit final të arbitrazhit. Tutje ka shtuar se nga përmbajtja e përgjigjes së palës kundërshtare lidhur me kërkesën për shpallje të ekzekutimit të këtij vendimi, vërtetohet se nuk ka asnjë arsye që të vendimi të anulohet por arsyet e dhëna janë të njëjta me ato që kjo gjykatë i kishte vlerësuar analizuar dhe për këto kishte vendosur me vendimin KE.nr.912/22, tani më i formës së prerë. Ka shtuar se të gjitha pretendimet e palës kundërshtare në seancën e sotme janë jo lëndore dhe të njëjtat tani më janë konsumuar në procedurën e zhvilluar në arbitrazh dhe në procedurën e zhvilluar në këtë gjykatë sipas vendimit KE.nr.912/22. Andaj duke marrë parasysh se nuk ekziston asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 36.2, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesa për shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të arbitrazhit.

Përfaqësuesi i kundërpropozuesit gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë përgjigjes të dhënë me shkrim dhe kundërshton kërkesën për shpalljen e vendimit të ekzekutueshëm, ku krahas argumenteve të ofruara me përgjigjen me shkrim, gjykatës i ofron edhe raportin e vlerësimit të ekspertit kundërshtimin e ekspertizës, ditarin ndërtimor të panëshkruar nga të gjithë akterët numër 131 i datës 12.08.2018 dhe fjalën përfundimtare e dorëzuar me shkrim nga kundërpropozuesi, nga të cilat shihet se vendimi i arbitrazhit ka të meta që e bëjnë të pamundur ekzekutimin e këtij vendimi, ngase i njëjti është nxjerr me shkelje esenciale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Ka shtuar se nga raporti fillestar kundërpropozuesi është ngarkuar me 16,338.70 € dhe pas ndërhyrjes tij ka pasur një korrigjim gjysmak respektivisht dëmi është ulur në shumën prej afërsisht 11,000.00 €, dhe përkundër faktit se kundërpropozuesi ka kërkuar që të caktohet një super ekspertizë për vërtetimin e saktë të

gjendjes faktike, kjo kërkesë nuk është aprovuar nga Tribunali i Arbitrazhit, andaj në këtë rast kundërpropozuesit i janë shkelur të drejtat procedurale, rrjedhimisht ngarkesa në shumën prej 11,000.00 € për punë që nuk janë kryer në dobi të propozuesit, e po ashtu edhe shpenzimet e procedurës të cilat rezultojnë në vështirësi financiare të pa tejkalueshme për propozuesin. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj kërkesën për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit numër ARB21/2018.

Gjykata pas vlerësimit të Vendimit të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit – Oda Ekonomike e Kosovës, Nr.ARB-21/208 të datës 19.12.2019 dhe pretendimeve gjatë seancës dëgjimore, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të arbitrazhit, në përputhje me nenin 38 të Ligjit për Arbitrazhin.

Sipas nenit 38 par. 1 të Ligjit për Arbitrazhin përcaktohet se: *“Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerrë nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga Gjykata”,* ndërsa me par. 2 të këtij neni përcaktohet se: *Kërkesa që vendimi i arbitrazhit të shpallet i ekzekutueshëm hidhet poshtë nëse Gjykata konstaton se ekzistojnë një ose më shumë arsye për anulimin e vendimit sipas nenit 36, paragrafi 2. Kërkesës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit sipas këtij neni i bashkëngjitet vendimi i tribunalit të arbitrazhit ose një kopje e vërtetuar e tij.*

Ligji për Arbitrazhin (NR. 02/L-75) në Kreu-n VII, neni 36, parasheh mundësinë e kontestimit të vendimit të arbitrazhit, nën kushte të caktuara edhe para fillimi të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit, respektivisht brenda 90 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga Tribunali. Në këtë drejtim, neni 36 i Ligjit parasheh se, secila palë mund të kërkojë anulimin e vendimit pranë gjykatës dhe gjykata do ta anulojë atë, nëse pala paditëse e cila ka kërkuar anulimin e vendimit dëshmon se janë plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore përfshirë edhe rastin kur përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të ketë patur ndikim në vendimin e tribunalit, neni 36.2 pika a) (v), apo nëse ekzistojnë rrethanat të cilat gjykata i vlerëson sipas detyrës zyrtare, kur arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj, ose ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public), neni 36.2 pika (b).

Bazuar në dispozitat e lartcekura për anulimin e vendimit të arbitrazhit duhet të ekzistojnë ndonjëra nga kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit për Arbitrazhin.

Kundërpropozuesi ka pretenduar se ekziston baza ligjore për anulimin e vendimit të arbitrazhit me arsyetimin se vendimi i arbitrazhit ka të meta që e bëjnë të pamundur ekzekutimin e këtij vendimi, ngase i njëjti është nxjerr me shkelje esenciale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, duke u bazuar në dispozitat e nenit 36.2 të Ligjit për Arbitrazhin.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se pretendimi i kundërpropozuesit se i janë shkelur të drejtat procedurale nga Tribunali i Arbitrazhit, sepse të njëjtit i është refuzuar kërkesa për caktimin e një super ekspertize për vërtetimin e saktë të gjendjes faktike, është në tërësi i pabazuar, për faktin se Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit konform nenin 23 par.3 të Ligjit për Arbitrazhin, mund të vendos mbi pranimin ose hedhjen poshtë të kërkesave për nxjerrjen e provave, andaj vendimi i atakuar i Tribunalit të Arbitrazhit nuk është përfshirë me shkelje nga neni 36 par. 2 të Ligjit për Arbitrazhin, ashtu siç ka pretenduar kundërpropozuesi.

Për më tepër pretendimet e kundërpropozuesit të paraqitura me përgjigjen në kërkesën për shpallje të ekzekutueshëm të vendimit të arbitrazhit dhe gjatë seancës dëgjimore, përbëjnë pretendime të cilat janë shqyrtuar në procedurën e zhvilluar sipas padisë për anulimin e vendimit të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit - Oda Ekonomike e Kosovës, Nr.ARB-21/208 të datës 19.12.2019, e të cilat pretendime gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara dhe si rrjedhojë edhe është refuzuar padia e këtu kundërpropozuesit si e pabazuar.

Meqenëse në rastin konkret nuk plotësohet asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 36.2 të Ligjit për Arbitrazhin, që do të shkaktonte anulimin e vendimit të arbitrazhit, e që rrjedhimisht konform nenit 38 par. 2 të Ligjit për Arbitrazhin, do të ishte edhe bazë ligjore për hedhjen poshtë të propozimit për shpalljen të ekzekutueshëm të të njëjtit vendim, gjykata vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj mbi bazën e të lartcekurave, e në bazë të nenit 38 par.1 të Ligjit për Arbitrazhin, gjykata e aprovoi propozimin për shpalljen e vendimit të arbitrazhit të ekzekutueshëm dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.738/23, datë 23.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, konform nenit 37.3 të Ligjit për Arbitrazhin, palët nuk kanë të drejtë ankese.